



PËRMBLEDHJA E RASTIT TË ARBITRAZHIT

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	Përmbledhja e fakteve.....	1
2.	Vlerësimi ligjor	1
(a)	Jurisdikcioni i Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës	1
(b)	Shqyrtimi i padisë.....	2
(c)	Shqyrtimi i Padisë së Ndryshuar dhe Kundërpadisë.....	2
(d)	Shqyrtimi i lartësisë së ndëshkimeve financiare dhe dëmeve tjera të Kundërpadisë.....	4
3.	Vendimi.....	3

1. PËRMBLEDHJA E FAKTEVE

Marrëdhënia juridike, ndërmjet të Paditësit “Kompania A” dhe të Paditurit “Kompanisë B”, ka filluar pas procedurës së tenderimit të inicuar nga Këshilli Drejtues i Projektit lidhur me projektin social për ndërtimin e 52 shtëpive për komunitetet e pakicave jo serbe në njërin nga komunat e Kosovës. Projekti ka qenë i bashkëfinancuar nga i Padituri dhe disa donatorë të tjerë. Pas këtij procesi tenderues, oferta e Paditësit është konsideruar si oferta ekonomikisht më e favorshme dhe Paditësi është përzgjedhur si Oferuesi më i sukseshëm dhe i është dhënë kontrata. Pas përmbylljes së këtij procesi, Paditësi dhe i Padituri kanë nënshkruar Kontratën për Shërbime Ndërtimore.

Përgjatë zbatimit të këtij projekti, punët ndërtimore të kryera nga ana e Paditësit, ishin konsideruar si me defekte dhe nën standard nga ana e të Paditurit, dhe për këtë arsye ishin caktuar disa takime midis këtyre palëve. Më tutje gjatë kryerjes së punëve, me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të dyja palët kishin themeluar një Komision të Përbashkët, i cili është themeluar për gjetjen e një zgjidhje të përbashkët. Me qëllim të zgjidhjes së problemeve, ky Komision kishte caktuar që testet e punëve me beton të bëhen pranë një laboratorit të pavarur. Pas testeve të kryera ka rezultuar se punët me beton kishin defekte. Pas këtyre testeve, palët ishin pajtuar që të sanonin defektet e punëve ndërtimore dhe palët kishin marrë vendim bashkarisht që të rrënoheshin disa shtëpi, me qëllim që të rindërtoheshin sërish. Por, me gjithë përpjekjet e palëve, puna e kontraktuar nuk po kryhej në mënyrën e kënaqshme. Sipas Paditësit, arsyet për mos kryerjen e punëve, ishin të jashtme dhe jashtë kontrollit të tij.

Si rezultat i mos kryerjes së punëve, i Padituri kishte lëshuar udhëzime të vlefshme për përmisimin e punëve të pakënashme, duke i dhënë Paditësit afate kohore shtesë për përmisim e tyre. Më 14 mars 2014, i Padituri kishte lëshuar udhëzime të vlefshme lidhur me shembjen dhe rindërtimin e shtëpive të Grupit 1, dhe afati për shembjen e tyre ishte data 12 prill 2014. Paditësi do të duhej të përfundonte shembjen dhe rindërtimin e këtyre shtëpive me datën 28 prill 2014. Në këtë fazë Paditësi, shembi pllakat dhe themelet e shtëpive për shtëpitë e Grupit 3 dhe 4. Por nuk kishte bërë sanimin e shtëpive nga grupet tjera. Paditësi kishte dërguar një letër në adresë të Paditurit duke dhënë arsyet dhe pozicionin e tij të asaj kohe, por i Padituri nuk kishte pranuar arsyet e Paditësit dhe më datë 16 prill 2014, i Padituri i kishte dërguar

vërejtje Padiësisit, e cila titullohet Njoftim për Mospërbushje të Kontratës. Një takim ishte mbajtur midis palëve dhe mbikqyrësit të punimeve “Kompanisë C”.

Më 21 maj 2014, i Padiuri kishte lëshuar një Njoftim për Mospërbushjen e Kontratës sipas Nenit 12, paragrafi 1, të Kontratës dhe më 17 korrik 2014, përfundimisht i Padiuri shkëputë Kontratën.

Më 23 korrik 2014, Padiësi ka parashtruar pranë Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës (TPA), padinë kundër të Padiurit për pagesën e 65,862.88 EUR për punët e kryera ndërtime sipas Kontratës me të Padiurin. Po ashtu, më 8 janar 2015, Padiësi ka parashtruar Kërkesë për Masë të Përkohshme.

Më tutje, më 24 korrik 2014, Padiësi ka parashtruar pranë TPA, kërkesën për pagesë në një shumë prej 34,111.00 EUR për punët shtesë, pagat dhe masat për sigurimin e punishtes së ndërtimit, që gjithësej arrijnë shumën prej 99,973.88 EUR.

Më 14 gusht 2014, i Padiuri ka parashtruar pranë TPA, Përgjigjen në Padi dhe Kundërpadinë duke kërkuar nga Padiësi shpërbimin e dëmit në shumën prej 605,984.22 EUR. Po ashtu, i Padiuri më datë 14 janar ka parashtruar Përgjigjen e Ndryshuar të Padië dhe Përgjigjen në Kërkesën për Masë të Përkohshme.

2. Vlerësimi Ligjor

a) Ligji i Aplikueshëm dhe Jurisdiksioni i Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës

Në bazë të Klauzolës B 3 që i referohet Klauzolës C 1.4, ligji qeverisës i Kontratës ndërmjet palëve është legjislacioni i Kosovës. Asnjëra nga palët kontraktuese nuk e ka sfiduar juridiksionin e arbitrazhit të TPA dhe Tribunali i Arbitrazhit pas vlerësimit të Kontratës ndërmjet palëve ka konstatuar se ka juridiksion për të gjykuar këtë rast.

Tribunali Arbitrazhit poashtu ka konfirmuar që gjuha që do të përdoret në arbitrazh do të jetë gjuha angleze, dhe vendi i arbitrazhit për shqyrtimin e kësaj çështje do të jetë Prishtina.

b) Shqyrtimi i padisë

Tribunali i Arbitrazhit, konsideron se më 27 dhjetor 2013, Padiësi ka kërkuar shumën prej 243,936, 59 EUR për përfundimin e punëve si pjesë e Punëve të mbuluara me Kontratën e Ndërtimit. Në Raportim Paraprak të Situatës, ishin aplikuar zbritje të ndryshme dhe shuma ishte reduktuar në 190,282.05 EUR. Sipas të Padiurit, kjo shumë nuk ishte e pranuar nga ana e tij, për shkak të defekteve në punët ndërtimore të kryera nga ana e Padiësit. I Padiuri kishte informuar Padiësin që punët ndërtimore të cilat ishin pranuar paraqisnin 70% të shumës së kërkuar, një shumë e përgjithshme në vlerë prej 124,419.17 EUR. Mbi këtë bazë, Padiësi kishte përgatitur dy fatura të përmirësuar në këtë shumë.

Padiësi pretendon se është pajtuar me të Padiurin, se shuma fillistare e kërkuar nga Padiësi do të paguhej tërësisht nga i Padiuri dhe punët me defekte do të sanoheshin nga i Padiuri pas përmisimit të kushteve atmosferike. Në anën tjetër, i Padiuri konteston ekzistencën e kësaj marrëveshjeje. Andaj nuk është kontestuese se i Padiuri i ka paguar shumë prej 124,419.17 EUR, pas pranimit të faturave nga ana e Padiësit.

Andaj, në Padinë fillestare, Tribunali i Arbitrazhit ka konstatuar se Padiësi ka kërkuar pagesën për punët e kryera me defekt, dhe për këtë Tribunali i Arbitrazhit refuzon si të pabazuar këtë kërkesë të bërë në Padi.

c) Shqyrtimi i Padiës së Ndryshuar dhe Kundërpadiës

Vendimi mbi meritat e Padiës së Ndryshuar dhe Kundërpadiës parasheh shqyrtimin juridik dhe faktik të zgjidhjes së kontratës nga ana e të Padiurit. Padija e ndryshuar bazohet në premisën se i Padiuri nuk ka pasur të drejtë të shkëpusë Kontratën. Kundërpadija parasheh të kundërtën. Tribunali i Arbitrazhit, ka shqyrtuar në dy këndvështrime shkëputjen e Kontratës së Ndërtimit nga ana e të Padiurit, nga njëra anë (i) aspektin procedural dhe (ii) aspektin material.

Tribunali i Arbitrazhit ka pranuar pozicionin e të Padiurit, nga këndvështrimi formal se Kontrata është shkëputur më 17 korrik 2014, 21 ditë nga përfundimi i periudhës së parë 14 ditore i paraparë me Kontratë. Andaj, Tribunali i Arbitrazhit ka konstatuar se nga ana formale, i Padiuri ka respektuar kushtet e parapara me Kontratë.

Sa i përket, aspektit material, Tribunali i Arbitrazhit, ka konstatuar se i Padiuri ka shkëputur Kontratën pas një sërë udhëzimesh të vlefshme për sanimin e punëve ndërtimore nga ana e Padiësit, dhe si rrjedhojë i Padiuri ka pasur të drejtë të shkëpusë Kontratën për shkak të mospërmbushjes nga ana e Padiësit. Andaj, Tribunali i Arbitrazhit ka konstatuar se i Padiuri ka shkëputur Kontratën në mënyrë të ligjshme dhe të vlefshme dhe Padija e ndryshuar, refuzohet si e pabazuar. Po ashtu, Tribunali i Arbitrazhit ka aprovuar këtë kërkesë të kundërpadiës të parashtruar nga i Padiuri.

d) Shqyrtimi i lartësisë së ndëshkimeve financiare dhe dëmeve tjera të Kundërpadiës

Tribunali i Arbitrazhit ka vlerësuar lartësinë e ndëshkimeve financiare dhe dëmeve të pretenduara në Kundërpadi. Duke ju referuar Neneve 250 dhe 256 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si bazë ligjore për zbutjen e ndëshkimeve të pretenduara nga i Padiuri. Tribunali i Arbitrazhit, konsideron se ekzistojnë katër çështje që shpiten Tribunalin e Arbitrazhit, për t'i zbutur dëmet e pretenduara nga i Padiuri, ato janë:

- 1) Përgjigjësia e kompanisë mbikqyrëse "Kompania C", e cila në mënyrë të pamjatuashme ka mbikqyrur punët ndërtimore;
- 2) Detyrimi i Padiurit të zbusë dëmet;
- 3) Elementet e vonesave që kanë ndikuar në progresin e punëve;
- 4) Mungesa e materialeve të mjaftueshme të dizajnit apo dizajni jo i qartë.

Për shkak të rrethanave të cekura më lartë, pretendimet për lartësinë e dëmeve të shkaktuara nga Padiësi ndaj të Padiurit në vlerën prej 297,406.89 EUR, janë pranuar nga Tribunali i Arbitrazhit afërsisht 20%, përkatësisht 60,000.00 EUR.

3. Vendimi

Tribunali i Arbitrazhit ka refuzuar Padinë dhe Padinë e Ndryshuar të parashtruar si të pabazuar, ndërsa kërkesën për shpërblimin e dëmit nga kundërpadija e ka aprovuar pjesërisht në shumën prej 60,000 EUR, e cila përfaëson 20% e shumës së pretenduar nga i Padiuri. Tribunali i Arbitrazhit ka vendosur se Padiësi është i obliguar të bartë shpenzimet procedurale të arbitrazhit në vlerë prej 27,712,48 EUR.

Ky Vendim është lëshuar nga Tribunali i Arbitrazhit në Prishtinë më 22.04.2015.